



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 971 Prot.

Tiranë, më 10 / 11 / 2014

Lënda : Dërgohen rekomandime për ndryshim në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar.

Drejtuar : Z. Erion VELIAJ
MINISTËR I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

TIRANË


I nderuar zoti Ministër!

Në zbatim të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, ju drejtohem për disa ndryshime në ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar.

Ligji “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, në nenin 4, pika 10, jep përkufizimin se çfarë duhet kuptuar me termin “Kryetar të familjes”. Kështu, referuar kësaj pike, përcaktohet se ; **me termin “Kryetar të familjes” kuptohet personi sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.**

Në bazë të procedurave që parashikojnë aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar, përcaktohet se është kryefamiljari ai që bën aplikimin për të përfutur ndihmën ekonomike në rastin e familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të panevojshme, duke i dhënë një pozicion të veçantë në procedurën për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Duke mbajtur parasysh këtë fakt dhe duke ju referuar përcaktimit që bën pika 10 e nenit 4, renditja që bën kjo dispozitë duke vendosur në radhë të parë babain, nënën, etj, vendos një



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

preferencë bazuar në gjini, ku vetëm në mungesë të babait, nëna do të konsiderohet në kuptim të parashikimeve të këtij ligji, si kryetare e familjes. Pra, mënyra se si është formuluar kjo pikë vjen në kundërshtim me parimin e barazisë, pasi përcakton një radhë preferenciale bazuar në gjini. Kjo gjë jo vetëm që nuk i shërben forcimit të rolit të gruas, që është një nga angazhimet e *Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, 2011-2015*, por sjell një dobësim të rolit të gruas në familje dhe në vendimarrjen e familjes.

Ndryshimet e fundit në ligj dhe nxjerrja e akteve nënligjore, me qëllim bërjen të mundur që të jenë gratë ato të cilat do të tërheqin ndihmën ekonomike, në referim të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, konsiderohen veprime pozitive, masa të përkohshme që synojnë përshtetimin e vendosjes të barazisë. Por, këto masa dhe të tjera veprime pozitive që ndërmerren për përshtetimin e vendosjes së barazisë, janë të përkohshme dhe të kufizuara në hapësirë dhe duhet të ndërpriten sapo të jetë arritur ofrimi i mundësive të barabarta.

Përveç vendosjes së preferencës në bazë të gjinisë, renditja që bën pika 10 e nenit 4, vendos preferencë bazuar në moshë, dhe konkretisht, formulimi “*anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç*”. Pra, mënyra se si është formuluar kjo pikë vjen në kundërshtim me parimin e barazisë, pasi përcakton një radhë preferenciale bazuar në moshën e individit duke i dhënë përparësi individëve më të mëdhenj në grup-moshën 18-65 vjeç, dhe individëve më të rinj në grup-moshën mbi 65 vjeç .

Sa më sipër, për të eliminuar parashikimet diskriminuese,

REKOMANDOJMË:

Riformulimin e pikës 10, të nenit 4, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “*Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore*”, në mënyrë të tillë që të eliminohet krijimi i preferencave me bazë gjinore dhe moshe, apo me çdo bazë tjetër.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

Konç. A. Çoko
K. Kamberaj



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al